



Funded by
the European Union



THIRRJE PËR APLIKIME

Mbështetje për biznese të vogla dhe nisma komunitare

Kthejeni idenë tuaj praktike në veprim.

AFATI: 30 SHTATOR 2026

A keni një ide që mund t'ju ndihmojë të filloni ose zhvilloni një biznes të vogël, të përmirësoni të ardhurat tuaja ose të sillni dobi për komunitetin tuaj?

Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM), në kuadër të komponentës për Stabilizimin e Komuniteteve të Programit të BE-së për komunitete, financuar nga Bashkimi Evropian dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë, fton individë, grupe dhe asociacione/kooperativa të aplikojnë.



Çfarë mund të mbështetet?

- Fillimi i një biznesi të vogël
- Përmirësimi ose zgjerimi i biznesit ekzistues
- Zhvillimi i një nisme komunitare që u sjell dobi komuniteteve joshumicë dhe forcon bashkëpunimin ndërmjet komuniteteve



Rezultatet prioritare

Ide praktike që mund të:

- Krijojnë vende pune ose vetëpunësim
- Rrisin ose ruajnë të ardhurat
- Forcojnë bashkëpunimin
- Mbështesin zhvillimin e komuniteteve

Kush inkurajohet të aplikojë?

Individët, grupet dhe asociacionet/kooperativat — veçanërisht gratë, të rinjtë, personat e kthyer, personat me nevoja specifike dhe anëtarët e komuniteteve joshumicë. Mirëpritën aktivitete të përbashkëta ekonomike me anëtarë të komuniteteve, fermerë, prodhues dhe shoqata biznesore ndëretnike.

Si do të vlerësohen aplikimet

- A mund të zbatohet ideja në praktikë?
- A mund të krijojë punësim ose vetëpunësim?
- A mund të vazhdojë pas përfundimit të mbështetjes?
- A mund t'u ndihmojë aplikuesve, familjeve ose komuniteteve të gjenerojnë të ardhura?

Aplikoni dhe mësoni më shumë

Udhëzimet, formularët dhe mbështetja:

www.kosovo.iom.int

Dërgojeni aplikimin me email:

iompristina@iom.int

Keni nevojë për ndihmë me idenë, planin ose formularin?

049 968 485 • 049 968 483

**AFATI PËR
APLIKIM**

**30 shtator
2026**

Shënim: Aplikuesit duhet ta dorëzojnë aplikimin vetëm në emrin e tyre, duke përdorur email-in personal. Çdo adresë email-i mund të përdoret vetëm nga një aplikues.